

KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Sot, më datë 27.02.2025, palët e poshtë cituara të kësaj kontrate, me vullnet të lirë dhe pëlqim reciprok, lidhin këtë Kontratë Shitje sipas dispozitave të mëposhtme:

SHITËS: **Arbër TEQJA**, i biri i Ermir dhe Arianës, shtetas shqiptar, lindur më datë 22.10.1985 në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga "Sami Frashëri", nr.4/11, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. personal I51022034R, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

(më tej referuar si "**Shitësi**")

DHËNËSE PËLQIMI: **Onejda Ymeraj**, i bija e Fadil dhe Zhaneta, shtetas shqiptar, me numër ID I55530051B, banuese në Tiranë

BLERËS: **Shoqëria "ANAMARK" SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe regjistruar pranë qendrës kombëtare të regjistrimit (QKB), me NIPT L52418031N, me adresë Tiranë, Kashar, Ish Ndërmarrja e Karburanteve, Km. 1 i Autostradës Tiranë - Durrës, Zona Kadastrale 2679, Pasuria Nr. 52/7.

(më tej referuar si "**Blerësi**")

(referuar veç si "**Palë**", dhe së bashku referuar si "**Palët**")

BAZA LIGJORE: Nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), si dhe nenet 73, 74 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).

DEKLARIME PARAPRAKE:

1. Shitësi është ortak i shoqërisë "ECO RICIKLIM" SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë QKB më 14/06/2016 me adresë: Elbasan, Bradashesh, Pasuria Nr. 1070, Zona Kadstrale 3965, Metalurgji, Bradashesh, me numër unik të identifikimit NIPT L61814009B, në të cilën zotëron 1 (një) kuotë e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 70% (shtatëdhjetë përqind) në kapitalin bazë të shoqërisë.



2. Shitësi kërkon të shesë Kuotën e zotëruar prej tij në shoqëri, ndërsa Blerësi Shoqëria "ANAMARK" SHPK, është e interesuar që ta blejë atë kundrejt çmimit EURO 60,000 (gjashtë dhjetë mijë Euro) dhe sipas kushteve dhe modaliteteve të përcaktuara në këtë kontratë, çka e ka konfirmuar në Vendimin e Ortakut të Vetëm të shoqërisë datë 27.02.2025.

Sa më sipër, palët lidhin këtë kontratë për shit-blerjen e kuotës, sipas parashikimeve të mëposhtme:

NENI 1

Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj Kontrate është përcaktimi i kushteve, modaliteteve dhe pasojave të transaksionit të shit-blerjes së Kuotës së zotëruar nga shitësi në shoqërinë "ECO RICIKLIM" SHPK, e cila përfaqëson 70% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit bazë të shoqërisë, në favor të Blerësit, sipas kushteve, afateve dhe modaliteteve të përcaktuara në këtë kontratë.

NENI 2

Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 2.1 Palët kanë rënë dakord dhe kanë përcaktuar se çmimi total i shitjes së Kuotës së zotëruar nga Shitësi do të jetë çmimit EURO 60,000 (gjashtë dhjetë mijë Euro).
- 2.2 Pagesa për blerjen e Kuotës, e përcaktuar në pikën 2.1 të këtij neni do të shlyhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

NENI 3

Kalimi i pronësisë mbi kuotën

- 3.1 Palët bien dakord se me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi bëhet pronar i Kuotës së zotëruar nga Shitësi, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 70% (shtatëdhjetë përqind) në shoqëri.
- 3.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, kapitali i regjistruar i shoqërisë "ECO RICIKLIM" SHPK do të zotërohet nga ortakët si më poshtë vijon:
- Ortaku shoqëria "ANAMARK" SHPK zotëron 1 (një) kuotë, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 70% (shtatëdhjetë përqind) në kapitalin e regjistruar të shoqërisë;
 - Ortaku Ervin Meçe zotëron 1 (një) kuotë, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 30% (tridhjetë përqind) në kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

NENI 4

Pasojat e shitjes së kuotës

- 4.1 Palët bien dakord se si pasojë e shitjes së Kuotës, Blerësi do të bëhet pronar i 1 (një) kuote e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes në masën 70% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit bazë të shoqërisë, pavarësisht momentit të shlyerjes së çmimit sipas nenit 2 të kësaj kontrate.
- 4.2 Shitësi do të jetë përfituesi i vetëm i dividendit të shpërndarë me vendimin nr.02, datë 27/02/2025 të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "ECO RICIKLIM" SHPK në vlerën EURO 730,000 (shtatëqind e tridhjetë mijë Euro) bruto, si pjesë e transaksionit të shitjes së kuotës së zotëruar prej tij në këtë shoqëri.
- 4.3 Blerësi do të angazhohet duke votuar në favor të çdo vendimmarrjeje në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë për shlyerjen në favor të Shitësit brenda 1 (një) vit muajve nga data e lidhjes së kësaj kontrate të shumës prej EURO 730,000 (shtatëqind e tridhjetë mijë Euro) bruto, të përfituar nga Shitësi si dividend sipas vendimit nr.02, datë 27/02/2025 të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë "ECO RICIKLIM" SHPK.
- 4.4 Çdo detyrim i Shitësit në lidhje me Shoqërinë, i cili daton përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate do të mbetet ekskluzivisht e tij.

NENI 5

Garancitë e Palëve

5.1. Shitësi garanton Blerësin se:

- 5.1.1. Zotëron 1 (një) kuotë në Shoqëri, e cila përfaqëson 70 % të kapitalit të saj bazë, i cili është në vlerën prej ALL 70 (shtatëdhjetë Lekë);
- 5.1.2. Kuota në tërësinë e saj nuk është subjekt sekuestrimi, ndalimi shitje, të drejtë parablerje, garancie bankare, apo e ndonjë mjeti tjetër i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve. Kuota e Shoqërisë gjithashtu nuk është subjekt i asnjë barre reale apo juridike;
- 5.1.3. Ka të drejta, aftësi dhe zotësi të plota për të vendosur shitjen e Kuotave dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik;
- 5.1.4. Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për autorizimin, ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate;
- 5.1.5. Përmbushja e kësaj Kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvete, Statutin e Shoqërisë, marrëdhënie

detyrimesh mes shoqërisë dhe të tretëve apo Shitësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi;

- 5.1.6. Asnjë person i tretë fizik ose juridik, në përjashtim të Palëve në këtë Kontratë nuk ka të drejta mbi kuotën apo kapitalin e Shoqërisë.

5.2. Blerësi garanton Shitësin se:

- 5.2.1. Blerja e kuotës që përfaqëson 70% të kapitalit bazë të Shoqërisë, të zotëruar nga Shitësi është në përputhje me vullnetin e tij;
- 5.2.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur blerjen e Kuotave dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik;
- 5.2.3. Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për autorizimin, ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate;
- 5.2.4. Përbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvete, marrëdhënie detyrimesh mes Blerësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi;
- 5.2.5. Vlera monetare e përdorur për blerjen e kuotës sipas Kontratës është krijuar si pasojë e veprimtarisë së ligjshme;
- 5.2.6. Blerësi nuk është subjekt i ndonjë proçesi penal lidhur me veprimtarinë e tij.

NENI 6


Data efektive e kontratës

- 1.1. Kjo kontratë është efektive, e detyrueshme për palët dhe trashëgimtarët e tyre, që nga data e nënshkrimit të saj.

NENI 7

Konfidencialiteti

- 7.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë dhe çdo negociim parakontraktor do të trajtohen në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do të transmetojnë asnjë të dhënë apo informacion lidhur me marrëdhëniet tregtare, financiare apo ligjore të njëra-tjetrës, si dhe se nuk do të bëjnë asnjë deklaratë lidhur me ekzistencën, objektin apo parashikimet e kësaj Kontrate.
- 7.2 Palët përjashtohen nga detyrimi i ruajtjes së konfidencialitetit në rast se:
- 7.2.1 Pala tjetër ka dhënë pëlqimin për transmetimin e të dhënave;
- 7.2.2 Transmetimi bëhet në kuadër të përbushjes së një detyrimi;



- 7.2.3 Transmetimi i bëhet një këshilltari të Shoqërisë, i cili është subjekt i detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit (p.sh. Avokatit, ekspertit kontabël, etj.);
- 7.2.4 Nevojitet për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të Palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- 7.2.5 Nevojitet për ndjekjen e interesave legjitimë të palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- 7.2.6 Këto të dhëna janë bërë publike nga vetë pala tjetër dhe ndodhen në domain-in publik dhe/ose janë të aksesueshme nga persona të tretë;
- 7.2.7 Këto të dhëna janë bërë publike ose i janë bërë të njohura palës që transmeton të dhënat nga persona të tretë.

NENI 8

Komunikimi ndërmjet palëve

- 8.1 Të gjitha komunikimet ndërmjet Palëve, si dhe kërkesat që ato kanë ndaj njëra tjetrës, do të kryhen në mënyrë shkresore ose nëpërmjet e-mail-it, në adresat dhe e-maillet e përcaktuara si më poshtë:

Për Shitësin:

Z. Arbër Teqja

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", nr.4/11, Bashkia Tiranë.

e-mail: _____

Për Blerësin:

Shoqëria "ANAMARK" SHPK

Adresa: Tiranë, Kashar, Ish Ndërmarrja e Karburanteve, Km. 1 i Autostradës Tiranë - Durrës, Zona Kadastrale 2679, Pasuria Nr. 52/7.

e-mail: _____

- 8.2 Në rast se personat dhe/ose adresat dhe/ose e-mail-et e mësipërme pësojnë ndryshime, Pala që i pëson ato ka detyrimin të njoftojë palën tjetër brenda 24 orësh nga momenti i ndryshimit. Në rast të kundërt, çdo komunikim në adresën e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm edhe pse mund të mos jetë marrë nga ana e Palës që ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresën dhe/ose e-mail-in.

- 8.3 Çdo komunikim ndërmjet palëve është konfidencial dhe nuk mund t'i transmetohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë personave të tretë me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 8.2 i kësaj Kontrate.

NENI 9

Interpretimi i Kontratës

- 9.1 Kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të Palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e Kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, Kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.
- 9.2 Ligji i zbatueshëm për interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, e më specifikisht, nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), si dhe nenet 73, 74 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" (i ndryshuar).

NENI 10


Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 10.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Kontratë, palët duhet të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.
- 10.2. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, Kontrata do të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 11

Forca madhore

- 11.1 Për qëllim të kësaj Kontrate, "Forcë Madhore" nënkupton një ngjarje që nuk shkaktohet dhe është përtej kontrollit të arsyeshëm të një prej palëve të kësaj Kontrate, e cila shkakton që përmbushja të detyrimeve të palës në këtë kontratë të bëhet ose e pamundur, ose aq jo-praktike sa, në mënyrë të arsyeshme, të konsiderohet e pamundur duke pasur parasysh rrethanat. Ajo përfshin ndër të tjera, epidemitë, pandemitë, gjendjet e fatkeqësisë natyrore, luftën, mosbindjen civile, stuhitë, përmbytjet ose grevat.



- 11.2 Në rastet e ekzistencës së kushteve të Forcës Madhore, afatet e parashikuara në të këtë kontratë për ekzekutimin e detyrimeve mund të shtyhen nëse është e nevojshme për aq kohë sa zgjat Forca Madhore. Forca Madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas Kontratës.

NENI 12

Të tjera

- 12.1 Bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj Kontrate janë:
- 12.1.1 Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë "ECO RIKIKLIM" SHPK;
 - 12.1.2 Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë "ANAMARK" SHPK
 - 12.1.3 Kopje e letërnjoftimit të Shitësit Arbër Teqja.
 - 12.1.4 Kopje e letërnjoftimit të përfaqësuesit të Blerësit Shoqërisë "ANAMARK" SHPK.
 - 12.1.5 Vendimi i shoqërisë "ECO RIKIKLIM" SHPK për shpërndarjen e dividendit.
 - 12.1.6 Vendimi i Ortakut të vetëm të shoqërisë "ANAMARK" SHPK për miratimin e blerjes së kuotës.
- 12.2 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate bëhet me pëlqimin e përbashkët të Palëve dhe do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim.
- 12.3 Kjo Kontratë përbëhet nga 7 (shtatë) faqe dhe është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë dhe një për t'u regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 12.4 Kjo Kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.

SHITËSI:

Z. Arbër TEQJA

Arber Teqja

DHENESE PELQIM

Qajda Ymeraj

Qajda Ymeraj

BLERËSI:

Shoqëria "ANAMARK" SHPK

Përfaqësuar nga administratori

Z. Asllan Fetiu

